



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 160, dt. 08.07.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 08.07.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohet kërkesa për llojin e shkrimit dhe formatit për tabelën e emërimit që do të vendoset në objektin: Liceu Artistik "Jordan Misja", Tiranë, me subjekt aplikues Bashkia Tiranë.
 - Miratohet varianti nr. 2 i shkrimit TW CEN MT 2 cm, vetëm emërtimi "Liceu Artistik Jordan Misja" në dy rreshta i qendërsuar.
 - Sipas vendimit të KKR NR. 75 dt. 13.04.2016 kodi i lyerjes së fasadës është RAL 1008 dhe RAL 9010.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI